



Prishtina 31/07/2006
ERO Code: D_12_2006

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Situatën e tanishme të furnizimit me energji në Kosovë;
2. Pëlqimin e dhënë KEK-ut nga ZRrE-ja, me datë 5 Qershor 2006; mbi Eksportin e Energjisë Elektrike gjatë muajit Korrik dhe Gusht;
3. Informatat zyrtare të pranuar nga KEK-u për situatën e tanishme me furnizim të energjisë elektrike, më datë 31 Korrik 2006; dhe
4. Dispozitën e Nenit 36.2 të Ligjit No. 2004/10 “Mbi Energjinë Elektrike”;

Në mbledhjen e mbajtur më 31 Korrik 2006 me shumicë votash ka vendosur të:

- a) Tërheq Pëlqimin e dhënë KEK-ut më 5 Korrik 2006 gjersa kushtet e Nenit 2 pika a) dhe g) të përmbushen.

Kapitulli 1: Procedura

1. Më 5 Qershor, ZRrE-ja i ka dhënë KEK-ut Pëlqimin për eksportimin e energjisë elektrike gjatë muajve Korrik dhe Gusht 2006.
2. Pëlqimi nën paragrafin 1 ishte dhënë nën kushtet e Nenit 36.2 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike dhe Nenit 51.3 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë me kushtet në vijim siç janë paraqitur në Nenin 2 a) dhe 2 g) të Pëlqimit, që:
 - a) “do të ketë energji të mjaftueshme elektrike për t’i përmbushur nevojat e konsumatorëve;
 - g) “nuk do të ketë reduktim për konsumatorët apo këto do të jenë minimale (gjatë konsumimit më të lartë).
3. ZRrE-ja ka marrë parasysh situatën e tanishme të furnizimit me energji elektrike, raportet e energjisë të pranuar në baza ditore nga KEK-u dhe informatat zyrtare nga KEK-u për situatën e tanishme të furnizimit, më datë 31 Korrik 2006.

4. KEK-u do të fillojë të implementojë këtë Vendim prej datës që Bordi i ZRrE-së e ka marrë këtë vendim apo prej datës që i dërgohet KEK-ut.
5. Ky Vendim do të zbatohet gjersa kushtet e furnizimit të normalizohen në mënyrë që të përmbushet politika ABC siç është miratuar nga ZRrE-ja, në rast të tillë KEK-u zyrtarisht do të kërkojë pëlqimin për të vazhduar implementimin e Kontratës së nënshkruar me OST Electra, më 30 Qershor 2006.
6. Kundër këtij Vendimi, Kek-u ka të drejtë të ankohet në Gjykatë kompetente brenda katërmëdhjetë (14) ditësh prej ditës së lëshimit të tij.

Në emër të Bordit të ZRrE-së
Merita Kostari
Anëtare e Bordit
